





Silke Liria BLUMBACH

---

LUMI QË RRJEDH DREJT BURIMIT

Biblioteka: PUHIZA  
Redaktor: Shaip EMËRLLAHU  
Ballina: Savash VELIU

Silke Liria BLUMBACH

**LUMI QË RRJEDH  
DREJT BURIMIT**

Poezi

Ditët e Naimit  
Tetovë, 2007



Shumë i dashur lexues,  
duke hapur këtë libër po fillojmë bashkëbisedimin, ndo-  
nëse nuk jemi të ulur bashkë në njërën prej kafeneve  
aq të lezetshme shqiptare, apo në ndonjë kënd tjetër  
të botës. Mbase jemi takuar më parë ose kemi për t'u  
takuar ndonjë ditë ...

„Lumi që rrjedh drejt burimit“ është titull i librit që mund  
të të shkaktojë habi, pasi lumenjtë rrjedhin zakonisht  
drejt detit. Edhe unë veten e kam menduar të tillë, se më  
tërhiqte deti me qytetin e tij, Sarandë, ku me të arritur  
gjykova që tani e tutje nuk do të lëvizja më, se ia kisha  
arritur qëllimit, se mund të pushoja pranë detit ...

Por, jeta e pat kërkuar ndryshe, dhe ndodhi e pamen-  
duara: jam kthyer në vendin që për vite të tëra e kisha  
mohuar me sa fuqi kisha, në luftën time pa sukses për  
t'u akomoduar si një shqiptare që isha në zemër. Jam  
kthyer në Gjermani, dhe tani për komoditet them përsëri  
se jam gjermane, por mësimi i vërtetë ishte që në të  
ardhmen, kategorive që i ndajnë njerëzit nga njëri-tjetri  
duhet t'u humb rëndësia. Kështu, duke transcenduar ku-  
fijtë e kombësisë, e kuptoj veten si kosmopolite... Këtë  
e dëshmojnë edhe poezitë e mia, që krahas pjesës dër-  
rmuese, të cilat flasin për marrëdhënien time me botën  
shqiptare, ka edhe poezi të frymëzuara në vende të  
tjera, siç janë Gjeorgjia dhe Hungaria. Gjithashtu, tran-  
scendoj edhe kufijtë e feve, duke kërkuar atë që është  
në qendër, prapa ose përreth dukurive dhe riteve të feve  
të ndryshme...

Pra, pikërisht ky është burimi në kuptimin figurativ, në  
kuptimin e thellë shpirtëror. Ky liber është një udhëtim  
nëpër njëmijë dhembjet e botës sime, nga fëmijëria e  
vështirë deri te ankthi pse s'ka vend për mua në këtë  
botë, duke kaluar nëpër zhgënjimet e dashurisë... Poez-

itë e ciklit „Letra nga ferri“ janë shkruar në depresion të thellë. Nganjëherë këto dhembje, në fund të poezisë, bëjnë kthesën në një perspektivë që e pajton njeriun me fatin, ose që e transcendon në një dashuri më të madhe – por, shpesh dhembja mbetet klithmë. Kështu e kam përjetuar – por, sapo të gjesh mundësi për të kapur vuajtjen në fjalët, edhe dhembja që duket se e vret shpirtin, kthehet në bukurinë e artit. Dhe, në qoftë se të pëlqen ndonjëra prej këtyre poezive të zymta, nëse të bën të ndiesh që edhe me hallet e tua nuk je krejt i vetëm, nëse të hapet zemra një çikë kur i lexon ose nëse të vjen një lot në sy – atëherë ia paska vlejtur! Se, siç shkruan poeti i madh portugez, Fernando Pessoa: „Gjithçka ia vlen, po që se shpirti nuk është i vogël ...“

Po të duhej të zgjedhja midis një jete të lehtë, të përciptë, dhe një jete sfiduese, të vështirë, që më lejon të mësoj sa të mundem për njerëzimin – atëherë, prapë do ta zgjedhja jetën time. Se edhe këto peripeci më afrojnë gjithmonë e më shumë te qëllimi, që „asgjë njerëzore nuk më është e panjohur“.

Udhëto bashkë me mua nëpër këtë lumë të çuditshëm, që nuk është si lumenjtë e tjerë, që rrjedh në drejtim të kundërt dhe që duket i pakuptueshëm në sytë e shumëkujt. Pse të çash kodrat dhe malet nëse është më lehtë të rrjedhësh nga larg poshtë? Unë jam kthyer aty nga jam nisur para më shumë se një dhjetëvjeçar, kur rashë në dashuri me botën shqiptare dhe fillova ta mësoja gjuhën shqipe, në të cilën tashmë u botua libri im i tretë. Kështu, gjithmonë do të jem në kërkim të burimit tjetër, nga vijmë ne të gjithë, nga vjen kuptimi i gjithë asaj që ne ende nuk e deshifrojmë. Dhe do të vazhdoj të këndoj për këtë kërkim dhe udhëtim, për ty dhe ju të gjithë, që t’ju hapen zemrat dhe t’ju kthjellohen mendjet. Dhe në fund të këtij udhëtimi marramendës, kur të më lejohet të pushoj në burim, do të kuptoj se burimi dhe deti, zanafilla dhe qëllimi, janë e njëjta gjë...

Autori





I LETRA NGA FERRI



## FRYMË

dhembje

trishtim

frymë merr frymë merr frymë

shkatërrim

dëshpërim

merr frymë e dashur merr frymë

fund

amulli

merr frymë merr frymë vazhdo

mbarim

vdekje

hiç asgjë

vazhdo vazhdo

merr

frymë.

## RIMË

Si  
të  
vazhdoj,  
pyeti miu,  
kur  
"pa"  
është  
kryefjala  
e botës?

Dëgjo,  
tha  
zëri,  
"mi"  
rimon  
me  
"shtëpi".

## IKJA

Ndoshta  
shpresa  
ka ikur  
me aeroplan  
- Albanian Airlines a Malévi -  
duke ma vjedhur biletën.

Ndoshta  
jeta  
kënaqet me luksin  
e një kryqëzate  
- nga Bistrica veriore gjer atë të Jonit -  
duke më lënë vetëm  
një hallkë zinxhiri pa spirancë.

Më ka ikur shpresa.  
Më ka ikur jeta.

Dhe vetja ime  
me një pallto të vjetër, tepër të hollë,  
edhe vetja ime  
radhitet në korridoret e pista  
të një enti të huaj për të huajt  
kërkon  
azil të kotë.

## BARKU I MADH I HISTORISË

Barku i madh i historisë  
gëlltit ngjarje  
dhe ylbere  
bashkë me fushat e hashashit.

Gllabëron yjet  
dhe të ziun e natës  
me salcën e këngëve  
heroike.

Gëlltit gojën që këndon  
dhe veshin që dëgjon,  
llup ëndrrat që shihen në ëndërr  
dhe mendjen e lodhur që ëndërron.

Vetëm një gjë nuk e ha dot  
barku i pangopshëm i historisë:  
vetveten.

## BARKA E VOGËL E HISTORISË

Barka e vogël e historisë  
çan si ngjalë e gjatë  
mes ishujve të fundosur,  
pa pëlhurë dhe pa rrem.

Barkën e vogël të historisë  
vetë koha e shtyn përpara  
me vrullin që fryn nga malet  
jashtëkohore.







## II NËPËR DETIN E SYRIT



## IRIQI TEPËR I DASHUR

Jam  
iriqi  
me gjembat përbrenda.  
Përjashta jam mi, gjahu  
i maceve dhe shpendëve të egër.  
Ata, kur me gojë dhe sqep më afrohen,  
nuk vriten nga gjembat e mi.  
Më mirë të më vrasin mua. Sepse  
jam një iriq tepër i dashur.

## TRUPROJA

Dua të rris iriqë, t'i mbledh rreth meje,  
si gurë në kështjellën time.

Qentë endacakë dua t'i zbus me ushqim  
dhe ledha, me fjalë të mira pa frikë  
Dhe do të më ndjekë një gardë e tërë  
truprojash, të armatosur me dhëmbë  
dhe me morra.

Iriqët e mi. Bukuritë e dashura yllësore,  
gjembat tuaj do t'i lyej me ar, që të shkëlqejnë.  
Qentë e mi të dashur. Pa mua do të kishit  
vdekur në përbuzje, në mjerim.  
Unë kam dhëmbë qeni. Kam eshtra iriqi.

## POEMTHI I LODHUR

nuk i radhis dot fjalët  
sot  
radhiten vetvetiu  
e pastaj  
më radhisin edhe mua

## KEQMËNGJESI

Në një shkretëtirë kozmike:  
keqmëngjesi, vetja ime.  
Mirëdita, askushi.

Më mirë se lindja e diellit, perëndimi.  
Kur sheh se nuk ka njeri, vërtet nuk ka.  
Kur nuk sheh gjë, dikush mund të ketë ardhur.

## ISAKU

Çdo natë e ndiej thikën mbi qafën time.  
Tavolinë e ngurtë më është bërë kurrizi.  
I vogël isha. Tepër i vogël,  
I ri si qengji i bardhë, vëllai im  
Me sytë e dhembsur, që më shpëtoi hundën  
Nga nuk del kurrë më era e mishit të djegur.  
Pothuajse mishi im. Pothuajse gjaku im.  
Unë baba nuk kam. Unë Zot nuk kam,  
Vetëm kujtimin e një qengji me sy të zbrazët.

## STYX

Kur të fusësh në gojë dyqindlekëshin  
për të paguar timonin e tragetit,  
kur të ulesh prapa tij për të lundruar  
nëpër ujërat pafundësisht të zeza,  
më trego gjithçka.

Më trego me trurin tënd absolutisht të qetë  
për qetësinë që e kërkoje dhe atë që e gjete.  
Kur të leh qeni me sy dhe vesh të kuq,  
kujtomë, vetëm për të më treguar:

a ke gjetur  
lumturi?



## UDHËTIM

Krimbi  
nuk u be kalë.  
Në aeroport rrjedhin lotë.

Në mollën e prishur  
fluturon krimbi si me aeroplan  
drejt koshit të plehrave.

## RËNDESA

Bie shpresa  
si fustani në një ditë vere  
të dëshpëruar.  
Bie në dysheme  
bashkë me brekët  
buzëqeshja.

Edhe pse të folën për fluturime  
drejt diellit edhe më tej.  
Edhe pse të gjithë flasin kështu.

Më e rëndë se tavani  
është zemra. Dhe jeta,  
ky labirint pasqyrash të thyera,  
aq rëndë të peshon  
sa burri i nevojshëm.

## KËNGË PËR NJË FËMIJË TË URITUR

Hëna po tallet me ne.  
Gjëja më serioze në botë  
është buza e fëmiut tim.  
Rrjeti ka mbetur i zbrazët.

Ta mbush rrjetin atëherë  
me trurin tim? Dhe çfarë  
të bëj pastaj me kafkën?  
Ah, sa larg na qenka hëna!

Nga larg qesh një kitare.  
Dëgjo, fëmiu im.  
Hëna të thur një rrjet tingujsh.  
Kurrë më s'do të kesh uri!

## MASKARA

Hiqi sytë. Hiqe gojën.  
Dy vrima të vogla dhe njëra e madhe  
Të mjaftojnë. Hiqe çorapin.  
Jo atë me lule. Atë të zi.

Shpirtin e ke hequr shumë më parë  
Në ndonjë kuletë të zbrazur  
Në një kasollë a pallat që bërtet.  
Maskën e zezë prej çorapi

Vishe mbi boshllëkun e trefishtë.  
Tash prite furgonin. Tash, me kallash.  
Priti turistët e etur për det,  
Ti vetë turist i njerëzimit.

## HIK FËT!

Mendimet vrapojnë, vrapojnë, vrapojnë  
në garë: cili vret më shumë, më shpejt, më gjatë...  
Mendimet ecin, ecin, ecin...  
burojnë, gufojnë, shtjellohen – ah!  
në rrathe si trekëndësha,  
trekëmbështa që më varin, që më vrasin.  
Në vdeksha unë, mendimet do vazhdojnë  
të vrapojnë,  
Shpejt - shpejt, fët - fët  
HIK FËT!

## FUNDI I NJË PULE

Muskujt vallëzojnë.  
Flatrat rrahin ajrin dhe tokën  
E qullur me gjak.  
Gjatë rrahin dhe fort  
Përreth një mesi që përpëlitet.  
Vallja e fundit e muskujve.  
Damarët nuk mbyllin dot rrethin.  
Mesi dridhet pa fluturim  
Në vaj të përhershëm dhe të shkurtër  
Për kokën e humbur.

## PËRHERË PËR TË KËNDUAR

Brenda këngës sime: dëshpërim dhe katër kuaj.  
Tunele. Tela me gjemba  
Edhe banka,  
ku pimë kafe pranë godinës më në fund të Iyer.  
Kantierë. Monumenti në rritje.  
Fotografi dhe shishja e zbrazët greke.  
Kurora e hekurt dhe etja për Liri.

Përherë, përherë do të kem për t'i kënduar:  
Murit të Berlinit dhe Rugës së Vdekjes.

## KISHA NJË HERË NJË PËRKTHYESE TË BUKUR

Kisha një herë  
një përkthuese të bukur. Ajo  
nuk di të thotë "jo".

Kubë! Të paskam gjetur. Do të bëj  
çdo gjë për ty. Australi! Kaledoni! Përse  
jo në Tiranë? Edhe ti  
nuk je krejt e panjohur. Ta shoh  
Gjermaninë në ëndërr. Vdekja  
është iluzion.



## DHËMBË DIMRI

Të kuqen e çastit e shtrydh  
në vrimën e dhëmballës.  
Sonte, pas punës, do ta shoh  
dentistin, që nuk njih agjërime.  
Valixhen nesër do ta mbush  
me buzëqeshjen time të arnuar.

## PSHERËTIME GJERMANISHT

Këtu  
dielli më pështyn në fytyrë  
me rreze të ngrira.

Mumijet mërdhijnë.  
Koha është luftanije,  
moti, tradhëti ekrani.

O vdekje o ikje –  
ikje nën plumbat  
e moskuptimit miqësor.

Lëkura çdo ditë  
vdes një ditë më shumë.  
Fytin na e shtrëngon mbijetesa.

Deti është bërë kartolinë  
e shpërlarë  
me filxhanët e kafesë së fundit.

## SHIGJETA DHE STËRKALA

Shigjeta nga ekrani  
shpojnë gjoksin. Shigjeta  
në petkun e lumturisë.

Në jetofsha në breg të stërkalave,  
ku më thonë "Këtu mungon vetëm ti"  
palmat, bukuviljet dhe iriqët,  
në jetofsha, ah, në jetofsha atje –

as delfinët as pulëbardhat  
nuk do të më shpëtonin  
nga shigjetat kudo në rrugë,  
që ma shpojnë gjoksin.

## SHI SI HEKUR

Shi si hekur. Perdja e hekurt.  
Perdja para çdo dritareje.

Deti është larg si dje dhe nesër.  
Këngët ngelen në fyt dhe poezitë në laps.

Ngjyrat nuk janë asgjë tjetër veç  
ngacmim retine. Pra mos më tregoni

për vende që nuk shihen as nuk ndihen!

## RRUFE

Sheshi Skënderbej në mes të shiut gjerman.  
Për një sekondë. Për një pikë shiu.  
Për një pikë gjaku fytyrat e miqve.  
Fytyra jote. Dhe jotja. Dhe jotja.

Pupla pulëbardhe në detin e syrit ...

Largimi i gjithçkaje. Largimi i të larguarve.  
Lëng vitaminash dhe të qeshura studenteje  
Në rrudhat e hirta të kujtesës  
Në skaj të shirave të skajshme.

## LUMI NUK RRJEDH PËR PJETË

Lumi  
nuk rrjedh përpjetë.  
Kot presim në majë të Kodrës.  
Kot presim nëpër pallate  
të palara.

Fëmijët dikur të njomë  
qajnë natën nga thatësia.  
Ne ujë s'kemi. Vetëm kripë  
dhe ujë që ulërijnë.  
Kupa e leshtë e deleve  
është zbrazur prej kohësh.

Lumi  
me gjithë shtrëngatën e thatë  
mbetet kokëfortë.

## POLIS

A do të mbeten buzëqeshjet që më prisnin  
atëherë në kohën e dallgëve të arta,  
me peshq që vetëm me gjishtat hahen,  
sepse kështu ka më shumë lezet?

A do të shëtitem vallë, si dikur,  
me buzë limoni dhe ulliri?

## VATRA

Vatra është prona e motrave.  
Unë si vatër ankthin e kisha.

Hekur rreth gjoksit.  
Litar rreth qafës.

Më mirë lëkura e lagur e nomadëve  
me shputat e gërryera nga ferrat.

Asnjë shtëpi nuk do të më digjet.  
Asnjë njeri nuk do të më ikën.

Besim, siguri, dashuri:  
përralla rreth zjarrit të vatrës.

Nuk ka vend për njerëz që  
nuk kanë askënd as vatër.



## ISHA

Isha. Isha e s'isha në akull dhe në shi,  
në vijat ngjyra-ngjyra në mes të qilimit gri,  
në dhomën më të madhe të shtëpisë së blertë  
në mes të luginës. Dhoma ime. Dhe unë  
në mes të urrejtjes. Në fushëbetejë të padukshme.  
Shkopinj. Britma. Shikime. Mendime.  
"Në shtëpinë e re", më thanë dhe shpresova  
mbi kolovajzën e fqinjve, "nuk do të jemi  
aq nervozë."  
O shpëtim. Shpresë e kotë:  
kur ikëm, gjithçka vazhdoi si më parë.  
Por ika unë  
nga shoqet. E vetme si vetmia vetë. Isha e s'isha.

## NDIHMË!

Ah! Ndhmë! Ndhmë! Mos më largo!  
Mos më braktis! Se kur ti ikën,  
bëhem fëmijë pa ninulla, pa dorë  
në ballë: Çdo gjë është mirë. Mos qaj.

Mos më braktis. Se mua më braktisi  
vetja ime. Këtë e di ti. Dhe kjo të jep  
fuqi mbi mua pa kufi: o jetë o vdekje!

Pra, do të luftoj si luane  
a luftanije: për ty, kundër teje.  
Luftë me emër dashuri. Përpjekja e fundit  
në viset ku gur për shtigje s'ka.

## URI

“Shumë mirë mund të mbijetosh  
me një markë në ditë.  
Kjo është e provuar  
shkencëtarisht. Nga mjekët.”

Faza e parë: nuk mendon dot më  
për tjetër gjë. Vetëm të hash.  
Faza e dytë: dobësi. Stërlodhje.  
Vetëm të flesh. Faza e tretë -

“Ajo është më e vjetër se ti.  
Çohu, dembele. Lirojia ulësen.  
Apo mos je me barrë?”  
Jo, nuk jam: singeritet. Dhe lotë.

Nëna ime e dashur shkencëtare.  
Bashkudhëtarja plakadashëse.  
Megjithatë, ca lekë i kam. Por nuk i ha.  
Janë për biletën për të fluturuar

drejt në burg.

## AUTOBUSI. NATA. PISHA.

Autobusi. Nata. Pisha.

Miqësi: vazo e thërrmuar.  
Hyjnesha e bregdetit hesht

dhe unë notoj me autobus  
në ndonjë ishull tjetër

vrasës.

## VAJZA VAJZA KOLOVAJZA

*vajza vajza  
kolovajza  
një herë kolovitesh  
një mijë herë shpotitesh*

Shishe birre dhe cigare  
në kohë të rritjes në provë të përhershme  
ku vetëm të ftohtit kalojnë. Të krisurit “cool”  
me gozhdë në gjuhë e gjetiu.

*vajza vajza  
kolovajza  
në fluturim kudoherë  
vajzë e përhershme e brishtë në erë*

Mërzia dhe papunësia.  
Ata, në parkun e lojërave, njëlloj çdo ditë,  
me helmin që pinë dhe helmin që flasin.  
Poshtë secili që nuk u përngjan.

*vajza vajza  
kolovajza  
jashtë mendjes së tyre kolovitesh  
asnjëherë më nuk do të shëtitesh*

*por zemra jote ruan këtë fluturim  
dhe ecjen zbathur dhe vallëzim  
për të cilin nuk duhet të ketë kufizim*





III TOKË NË DETIN E SYRIT

## JETUAM E JETUAM

Dhe ne jetuam e jetuam. Por ndonjë natë  
si kurdoherë  
U shkëput nga qielli një yll. Nuk ra tek ne. Ra  
në ndonjë lagje tjetër,  
Në kopshtin e ambasadës, sigurisht. Por  
edhe ne  
pamë një gjurmë ndriçuese në qiell. Dhe ne  
jetuam e jetuam.



## KAM

Kam kulm mbi kokën dhe nxemje në banesë.  
Kam shkollim, formim, aftësim.  
Kam një nënë, një babë, një motër  
dhe një gjyshe.  
Kam punë.

Nuk kam unazë në bark apo në gjuhë.  
Nuk kam kartmonedha me tri zero.  
Nuk kam burrë. Nuk kam fëmijë. As qen nuk kam.  
Nuk kam pjatalarëse. Nuk kam makinë.

Kam gjurmë hijesh, kujtime hijesh, krijime hijesh.  
Kam një vuratë mbi gjirin e djathtë.  
Kam barna mjaft. Kam sigurim shëndetësor.  
Kam miq.

Nuk kam halle për bukë. Nuk i kam më.  
Nuk kam pasaportë jugosllave.  
Nuk kam azil se nuk më duhet.  
Nuk kam mina në oborr.

Kam të drejtën të udhëtoj ku të dua.  
Kam vizë, lejen e punës, lejeqëndrim.  
Kam të drejtat e njeriut dhe të gruas në valixhe.  
Kam fatin e lindjes, avantazhe, privilegje ...

Nuk kam faj.

## NYJE

Nyja  
nyja gordike e Ballkanit  
sikur nyjet që bëjnë  
që këpucët të mos bien nga këmbët.

Dje të fola për nyjet.  
Sot digjen gjethet dhe pemët.  
Është herët mor ...

Nyja gordike e sfingeve të ngordhura  
nordike, me shikim drejt së ardhmes së kryer.  
Gramatika e nyjeve:  
disa më lidhin lëkurën me këmbën,  
disa lidhin pikëpyetje mes vete.

## MUR, MUR BËHET GUR

Mur, mur bëhet gur.  
Në Berlin. Në Mitrovicë. Në oborrin tënd.  
Në vilat e të kamurve.

Mirë, apo? Çlirimi qenka,  
që mbiemrin e ka shkatërrim.  
Mur, mur bëhet gur.

Tash, pa muret, kur mund të na godasin  
raketat edhe rriqrat dhe mallkimet –  
për herë të parë, syrin tënd e shoh.

## MBI KUDHRËN E JETËS

Mbi kudhrën e jetës.

Unë gur nuk jam. Teh dua të jem.

E mprehtë të jem. Fuqi të kem.

Do dal thikë. Do dal çelik.

Do dal çikë.

## GRUAJA QË HANTE PROTONE

Ishte njëherë një grua që hante  
Protone për drekë dhe për darkë.  
Jo elektrone të vockla. Protone gjigante  
Nga mbretëria e së padukshmes.  
Jo elektrone negative. Madje i refuzoi  
Neutronet, ndonëse ishin të mëdha.

Jo neutralitetit. Jo normalitetit. Jo jetës bajate.  
Protone dhe asgjë tjetër. Pikë.

Ishte njëherë dhe është një grua  
Që ha protone për drekë dhe për darkë,  
Të mëdha, pozitive, të padukshme  
Për njerëz bajatë si as unë, as ajo.  
Dhe nëse ndan me ne këtë shije ekskuizite,  
Eja! se do të të qerasim edhe ty.

## JETA NË FYTIN E NJË PËLLUMBI

Retë notojnë  
Poshtë në rrugët si luftanije  
Nëndetëse.

Çel befas jeta në fytin  
E një pëllumbi rrugaç.  
Cicërin më bindës  
Se bilbilat e radios.

Retë vazhdojnë  
Pezull.

Ngrihet dhe i kapërcen  
Jeta e lehtë, lehtë  
Nga fyti i pëllumbit.

Nëndetëset japin zjarr.

## BRICJAPI QË DEL NGA JANARI

Shkallët e pafund të Portugalisë.

I zbardhojnë vertikalisht qytetet  
dhe ushqejnë macet e dobëta me peshq.  
Gra të hijshme me kova në kokë  
balancojnë ullinj të, fatin dhe mallin.

Azeitonas. Fado e saudade.<sup>1</sup>

Shpëtoi bricjapi nga janari,  
nga përkrenarja e shpuar me shpatë.  
Shpatin e malit e zbret shkathët, shkathët  
si shkallë mundimi dhe malli.

Bricjapi që del nga janari.

Mes kovash me plehra, një nënë pa karrocë  
me foshnjen e mbështjellur si çokollatë.  
Barra e foshnjes dhe zhegut rëndon.  
Peshqit kundërmojnë.

Fëmija kap brirët e cjamin dhe qesh.

---

<sup>1</sup> Portugalisht: “Ullinj. Fati/Muzikë ‘fado’ dhe mall.”

## VASHA

Në këtë kodër është varrosur, thuhet,  
një vajzë e keqe, mu në mes, larg sipërfaqes.  
O moj vashë e zezë si korba  
me shpirt të pastër si ulliri!

Në këtë det të thellë është mbytur  
një kodër me një arkivol në zemër.  
O arkivol i zi si vasha  
me eshtra të bardha si hëna!

Në këtë pëllëmb të dorës zgjohet  
dalëngadalë, vullkani me sy të zinj  
si gërshetat e vajzës së keqe,  
gërsheta si lule, të prerë përgjithmonë.

O moj vashë e mirë, e mirë,  
dridhu mbi kodrat dhe mbi detin,  
kërcej mbi arkivolat dhe vullkanet,  
vdekjen dhe jetën gërshetoji,  
korba, ulliri, shkaba, TI!



## ZËRI IM !

Pusho  
në gojën time.

Të solla kontrabandë në Shqipëri.  
Azilin na e gjeta.

Koha kalon  
drejt dëbimit.

Kapemi pas gërxeve shqiptare.  
Koha na shqelmon.

Ti  
bërtet  
më lart.

## DËSHIRORJA

Paça gjithë kohën e botës. Paça gjithë botën e kohës.

Kërcefsha përmbi zemrën time. Kercefsha përmbi grykën e moskthimit.

Notofsha me delfinët në detin e Delvinës.

Krijofsha të pækzistuarën pa kufi. Krijofsha të pækzistueshmen.

Mos u varrofsha. E varrofsha ankthin.

## DOLA NGA BODRUMI

Dola nga bodrumi. Tani  
jam mbi çatinë. Gati  
për t'i hapur krahët.  
Mirupafshim, pra. Më mirë se Korfuzin  
e njoh Rinasin në thjeshtësinë familjare,  
ku më përqafojnë nëpunës të mirënjohur.

Ah, bodrumin e lashë poshtë.  
Kurrë më s'do t'ia thith pluhurin.  
Pluhur vetëm nga rrugët shqiptare  
për mushkëritë e mia të etura  
për verë, liri, për fluturim,  
për Onhezmitin nga mushkëritë e miqve.

Dola. Plasa. Jam në kulm  
pa motor e pa rrota. Pa pasagjerë,  
sa lirisht do të më vijë lartësia!  
Shqipet u mbyllën në flamur. Po pulëbardhat  
me bardhësinë e pulës fluturuese më presin  
bashkë me tetë këmbët me ventuza në pjatë.

Dola nga bodrumi. Tani  
gjendem në erë. Por nuk jam unë  
ajo që fluturon. Është fluturimi vetë  
që më ka rrëmbyer. Dridhem  
prej gëzimi të thepisur: o Sarandë o kurrë!  
Më i lehtë se ajri do të jetë dheu.

## O TIRANË

O Tiranë.

Nuk je as kasetë as kartolinë.

Duhet të jesh rritur si fëmija që mbahej  
nën zemër.

Ndonjë ditë do të lindemi bashkë.

Do të më lindësh mua. Do të të lind ty.

## ALLIAS

Lagje e pistë, e përbuzur, e mallkuar  
E keqkuptuar si Shqipëria vetë!  
Ëndrra e ligë për qytetarët, që mbajnë  
Nën jastëk dëshirën për rrymë të padukshme,  
Por magnet për malësorët në shtëpitë e ndërtuara  
Me më shumë shpresë se gur.

Ti pyet, a ka njerëz të mirë në Allias?

Natën, kur iknin dritat për t'u argëtuar,  
Argëtoheshim dhe ne duke treguar barcoleta.  
Lugët e drunjta dhe buzëkuqet i përdor akoma  
Dhe taketukja është për mysafirët.  
Por dhurata më e bukur që mora në Allias  
Qenka dëshira për t'u kthyer.

## GJYSHJA SARANDJOTE

Në Sarandë, në atë vend  
që aq shumë qenka bërë i imi,  
gjyshe, të kam parandier.

Do të takoja në Sarandë, besoja,  
në një kasollë, një plakë flokëbardhë  
dhe zemërmirë, si gjyshja  
në vendlindjen time, larg.  
“Më në fund!” do të më thirrte me gjithë  
buzën në gaz.  
“Sa jemi të gëzuar! Dhe sa të kemi pritur!”

Kur arrita një natë dimri plot polifoni,  
ti më pe, m’u afrove dhe më përqafove.  
Prej asaj ore kam një gjyshe në Sarandë.

## TRI DHITË

Janë kthyer nga helli  
Të tri dhitë e shkathëta  
Të Akrokeraunëve!

Gjashtë brirë në vapë. Gjashtë brirë të vegjël  
Mbi tri përkrenare të gjalla  
Nëpër fushat tona përreth shtëpive tona  
Nga dheu. Fshati merr frymë përsëri.

Dhitë e bardha si zemra e dritës  
I kemi pritur një gjysmë nate  
Dhe një gjysmë mijëvjeçari.

## GJARPRI

Rrotullojnë yjet dhe pemët  
Në vorbullin e daulles,  
Rreth ciklonit të klarinetës,  
Që i nxjerr mendimet jashtë trurit.  
Këngët me gjemba janë  
Kamxhiku i dasmës.  
Fluturojnë gjarpërinjtë në erë të djersitur  
Përreth faqes së skuqur. Së tmerrshme. Së lumtur.

Njëri nuk do të fluturojë më. Vallja mbaroi  
Për gjarprin e përzgjedhur në dhe.  
Ndonjë ditë pas epokave të arta,  
Pas epokave të zvarritura kuq-e-zi  
Do t'ia gjeni prapë kokën e urtë  
me gjuhën e thyer  
Mes gurëve amtarë, mbi një gur të skalitur,  
Dhuratë ilire për Shqipërinë,  
Dhuratë dasme e Meduzës për Medaurin.



## SHPELLAT

Kjo tokë më ka lindur nëntëdhjetë e një herë,  
nga shpellat dhe nga trupat e çiftelive,  
ne dritën e qirinjve, të zjarreve dhe cigareve.

Në dritën e varreve,  
se nëntëdhjetë herë kjo tokë më ka varrosur  
duke i tretur lulet e plastikës në manushaqe  
të vërteta.

Manushaqe që presin vjersha dhe valle,  
që pjekin bukë me borë dhe lidhin  
foshnjat e hirit  
dhe nganjëherë tundin një kokë luaneshe.

Luanët janë kthyer në ujqër, se stepa  
gjendet larg,  
dhe fishkëllijnë mes dhëmbëve të mpirë  
përreth shpellave të jetës-vdekjes-jetës.

## DHURATA

Arusha e kuqe, që lëshon tinguj të çjerrët, pa  
pushim, bezdisës, sepse nuk mbyllet dot.  
Nga Mitrovica. Nga vajza që Gjermanisë  
i ka lindur një refugjat.

Buzëkuqet në shitore pranë stacionit të  
autobusit në Allias, autobusit tonë, tek  
karburanti.

Nga Shqipja, të cilën duhet ta frenojmë,  
sepse përndryshe ma dhuron gjithë botën.

Nga shefi i drurit, nga Shefkiu, burri symirë  
i Shqipes, të bëra nga duart e tij, lugë  
të drunjta.

Si në përrallë: futi në gojë dhe do të kesh  
bukë përgjithmonë.

Libra. Libra. Libra. Libra. Libra.

Kutia prej mermeri për sekretet e Shqipërisë.  
Dhe rosa e mermertë  
që nga liqeni i taketukes pi duhan.  
Nga rromët, fqinjtë e mi, bashkë me dairen  
dhe të ardhmen në filxhan.

Shqipja prapë: çfarë do? merr çfarë të duash  
nga banesa ime!  
Trëndafila prej plastiku, të përjetshëm, më të

mëdhenj se çdo trëndafil tjetër.

Durrësi katërkëndësh. Shqipëria

e rrumbullakët prej bakri.

Saranda dydimensionale, gjithmonë pranë

meje, mbi komodinën në spital.

Emri im.

## PANTA RHEI

Isha shkretëtirë e një kozmosi  
që dukej mospërfillës.  
Isha flaka që ndriçon e shpërndan shkëndija  
e shuhet e zhduket,  
Por jo krejt.

Jam vendi ku shkrihen bota e poshtme  
dhe ajo e sipërme.  
Jam çasti ku e ardhmja kryqëzon të kaluarën  
duke pjellë të tashmen.  
Jam enigma.

Do të jem zjarri hyjnor, kristali i çiltër.  
Do të jem ena, gjuha, dora e së Shenjtës.  
Do të jem Dritë me dy krahë në rrathë, në rrathë.



## IV NË VENDIN E DARDHAVE

## MBYTJA E SHQIPTANIKUT

Me thikën e vjeshtës në shpinë. Mërdhij  
nën pallton e zezë, sorollatem në rrugë,  
e përndjekur  
nga flokë dëbore dhe nga kujtimet.

Mos fol për udhëtimet. Do të të urrejmë.  
Nga perëndimi në veri e në juglindje prapë,  
Opopo. Ndërsa për ne, ikje dhe udhëtim,  
Perëndim, kjo do të thotë  
Funddeti.

*jemi bërë alga jemi bërë peshq  
mbaroi mërzia mbaroi uria*

Na ke munguar, mua m'u tha,  
gjatë endjeve të tua në skajet e botës dhe jetës.  
U mbyt Shqiptaniku. Unë e mbaj veten  
me një copë buke me reçel dhe ca fjalë të mira,  
që do të çbëhen si tym e shkumë e gëzim.  
Faqet i nxjerr nga ditari, i shqyej në copa  
të bardha  
me vija të kaltra si deti. Gabim shkrova.  
Të mbytura  
në tavllën e duhanit, asnjë sy nuk i lexon dot më.

Mos fol për shpresë. Do të tallemi me ty.  
E ke kollaj ti të shpresosh dhe të besosh.  
Në zemër asnjë thikë nuk hyn aq mprehtë

Sa thika e vërtetë dhe thika e bukës  
Që nuk ka.

*feniksët e Finiqit delfinët e Delvinës  
tokën e kemi varr detin e kemi djep*

Pas viteve të hekurta do iki në Kosovë,  
pas ëndrrave të shuara në tavllën e duhanit.  
Në "vilajetin e errët" shkoj. Në kasollen  
me kulturë.

Çiftelia di, një tel për sy, të thajë lotë.  
Këmbëkryq pranë sofrës do të rris rrënjë  
për t'u lidhur më në fund me një tokë që  
më ushqen.

Do vijë dita kur flijimi të bëhet flijë.

## PUSI

Pika helmi në ibrikun e çajit  
dhe në qumështin e pelave.  
Lugina hesht.

Përse më shikojnë nga fundi i pusit  
njëzet e një sy?

T'i nxjerr dhe sytë e mi.  
Asnjë pikë ujë  
s'do ta pi më.



## PLISI

Rrihe delen derisa të bëhet plis,  
me raki të vakët rrihe.

Plisi është anija jonë e bardhë,  
me të cilën do të udhëtojmë

jashtë Kosovës dhe  
jashtë vetvetes.

## GRE-MINA

Të thashë që tek ne, rrugët i hanë njerëzit!  
Ta thashë dhe e pe në televizion,  
dhe kundërmimi i kufomave nuk ta djeg hundën  
vetëm sepse ende nuk ke shkuar në qytet.

Por dije se arat tona gllabërojnë bujq,  
që patjetër janë shumë më të shijshëm  
sesa qetë,  
dhe malet me oreks i brejnë barinjët  
me dhëmbë të rrumbullaktë, të padukshëm.

Po më së shumti livadhet i lakmojnë fëmijët.  
Ujqërit nuk duhen më. Livadhet  
e bëjnë punën vetë,  
dhe kur fëmijët e mëdhenj nuk u futen në turi,  
kafshojnë e gëlltisin – shpërthim! – një këmbë.

## I NUMËROJ DITËT

I numëroj ditët.

Dje tetëdhjetë. Sot shtatëdhjetë e nëntë.

I numëroj ditët.

Gjithmonë e më pak, gjithmonë e më pak.

I numëroj ditët.

Afrohet dita. Afrohet jeta.

I numëroj ditët.

Eci nëpër lumin e thellë.

I numëroj ditët.

I ngjitem malit. Deri në majë.

I numëroj ditët.

Kosova!

I numëroj ditët.

Shqiponjë e bardhë jam, fluturoj, fluturoj.

I numëroj ditët.

## NË VENDIN E DRERËVE

Verde, como te quiero, verde.<sup>2</sup>

Federico García Lorca

Mirë se vini në vendin e drerëve  
prapa tunelit hyrës "Marquez-Kundera".  
Drerët na i vranë dhe brirët  
e dhive të bjeshkëve janë thyer.  
Vetëm një orë në vit gjethet janë gjethe  
mes përqaftimeve prej akulli dhe zjarri.

E kuqja dhe e blerta, thonë,  
janë ngjyra komplementare.

Mirë se vini në vendin e drerëve,  
që në ëndrrat na flasin për një stinë  
kur vraponin vetëm drerët nëpër bjeshkët  
dhe jo turistët e varrezave.  
Ne zgjohemi dhe e ngulisim trurin  
mbi bar që tash për mrekulli harliset.

E blerta dhe e kuqja janë  
ngjyra komplementare.  
E përherëblerta përmbi dhe.  
Nën dheun, e përherëkuqja.

---

2 Spanjisht: "E blerta, sa të dua, e blerta."

## RRAFSHI I TETË<sup>3</sup>

Pëshpëritej në kohën e ylltë, kur mështekra  
para shtëpisë së gjyshit përkulej në erë  
Se në një vend të pjerrët shtrihet rrafshi  
që nuk është si të shtatë rrafshet e tjera,  
Pëshpëritej dhe dëgjoja me gishtin në gojë  
pranë sobës nën pemën e Vitit të Ri  
Të stolisur me ar dhe me engjëj. Rrafshi i tetë  
me qenie të çuditshme  
Nga mish dhe gjak dhe plumb dhe shkronja.

Jetonim në rrafshin e tretë me dele dhe keca,  
grurin dhe gurin,  
Kurse i dyti rrafsh ishte i kaltër si sytë e mi  
në një mëngjes prilli  
Dhe si zjarri i metaleve pa vlerë në orë  
mësimi të kimisë  
Dhe aq i lëngët sa pështyma. Dhe anije  
kishte, më shumë se ëndrra, më të mëdha.  
Andej gjendej rrafshi i parë. Ai i pafjalë.

Katër dhe pesë: nuk di gjë. Flija gjumë  
kur m'i këndonte gjyshja.  
Më i bukur ishte rrafshi numër gjashtë  
krejt vrima-vrима,  
Me bimë që më shumë se luleve, iriqëve  
u ngjanin,  
Por kokën e pushova në Rrafshin e Kosit,

---

3 “ova” = turqisht për “rrafsh”. Poezi kushtuar Tetovës.

në Rrafshin e Kosit, në Rrafshin e Kosit  
Te bardhë, të butë, ku malet janë nga djathi  
dhe lumenjtë nga qumështi.

Po pëshpëritej pranë sobës së ylltë në  
kopshtin e argjendtë të gjyshit të humbur:  
Rrafshi i tetë, ai rrafsh të pret, veç dy herë në  
jetë, qofsh argat ose mbret,  
I teti rrafsh plot me kafshë, me mëndafsh,  
rrafsh me afsh,  
Kështu pëshpëritej e flitej thirrej bërtitej, dhe  
fjalët më hynë në veshët si shigjeta,  
Pra kosin e tunda nga çizmet e mia dhe ika  
dhe erdha dhe qenkam këtu.

## KOSOVA DHE UNË, DUKE U ZGJUAR NGA NJË ËNDËRR E LIGË

Mirëmëngjes, Kosova ime.  
Unë di që ti nuk fjete mirë.  
U përpëlitte, rënkove në ëndërr.  
Vdekja të ndjek deri në shtratin  
e natës paqësore.

Por jemi zgjuar bashkë, jemi zgjuar!  
Të hamë një kokërr veze. Të pimë kafe.  
Pije dhe shih pak nga dritarja.

Do ketë pemë e lule. (Do ketë jetë.)  
Edhe këtu.

Për sa kohë do ta mbajmë tmerrin në palcë?  
Mos, mos u kujto, Kosova, moj.  
Erdhi mëngjesi ynë me diellin dhe cicërimë.  
Kemi harruar si shijohet jeta  
E cila dukej si një ishull shumë i largët.

Por ne jetojmë! Jetojmë ende!  
Mos e harro dhe merr frymë thellë.  
Shih, prapa perdes na fillon pranvera.

Do kthehen dallendyshtet. (Do kthehen  
shpresat.)  
Edhe këtu.







V NUK ZËVENDËSOHET DETI

## GURI NË GJOKS

Me gurin u zgjova,  
gurin në gjoks,  
atje ku ju e keni zemrën.

Dhuratë e bukur për Vitin e Ri.  
Më mirë gur se thikë.

Thikën e mbështolli guri.  
Gurin e mbështolla unë.  
Jashtë bën ftohtë. Edhe brenda.

## EDHE KARTOLLAT KANË ZEMËR

Ngjyrat radhiteshin në ekran në ylber.  
Ngjyrat që nuk kishte gjetiu: as në qiellin  
e banalizuar, as në thonjëzat.  
Radhiteshin dhe përpiqeshin kot të nxirrnin  
ndonjë buzëqeshje. Ndonjë shpresë.  
Vetëm një ofshamë e nxorën, që ndoshta  
është gjysma e shpresës. Ose stacioni i parë,  
po të ishte autobus,  
Si autobusat që shkojnë përtej maleve. Si  
anije-furgonat me kukësi të durueshëm,  
që të lundrojnë nëpër detin e tyre.

„Malet kurrë s’do ta zëvendësojnë detin.“

Nëntëdhjetegjashtëshi. Poshtërimet me radhë:  
fshihu në korridor, ke kombësinë e gabuar,  
je njeri i gabuar, duhet të zëvendësohesh!  
Në emër të intelektit, të letërsisë, gazetarisë.  
Në emër të pastërtisë së kaluar, asaj  
të kampeve të përqëndrimit.  
Edhe kartollat kanë zemër. Dhe nuk fshihen  
në korridor as nuk zëvendësohen.  
Dhe nganjëherë hakmerren.

Ende nuk paske arritur. Deti është larg.  
E gjatë qenka udha. Ka gurë në erë.

## MBRETËRESHA

Nën gurët e kalldrëmit do ta kërkoja sqepin  
tënd, po të mos ishin të ngrirë.

Nën batanijet e holla fshihen,  
duke u dridhur, revoltat.

Vargmalet e borës i kam varur rreth qafës,  
bashkë me lopatën.

Mure betoni do t'i varros me orteqet e mia.

Më lini të çbllokoj gjuhën e bllokuar, mendjen  
e frenuar, lumenjtë e ngrirë.

Ta kërkojmë mbretëreshën. Duhet ta gjejmë.

Koha e pret.

Sundimin ia ëndërrojnë gjithë që nuk janë lopë  
dhe mitrat që nuk janë fabrika.

Ah! Mbretëresha mbi fronin e ngurtë!

Do të ta hap sqepin prej guri. Do të t'i hap  
sytë. Në qoftë se të gjejmë.

Do të të gjejmë.

## AS GJAKU NUK E ZËVENDËSON DETIN

As gjaku nuk e zëvendëson detin.

As ai nëntokësor, që thithet nga rrënjët  
e vockla të luleve dhe pemëve, për t'u gatitur  
e gatuar në gjellën e harresës së gjallë,  
As nuk ai që merret nga njerëz të marrë  
dhe falet me flijë në ditët e lindjes  
dhe ende-jo-vdekjes.

Por as nuk ai gjak ngjyrëçelët, i çiltër,  
që baticon-zbaticon nëpër pulset,  
Gjak turbullues, që të fut në damarë verë  
të kaluara,  
Ëndrra të shuara, shikime, vallëzime,  
kërcënime,  
Gjak që të rrit rrënjë të vockla  
nën eshtrat e thata,  
turbullues, trazues, vlues –  
jo.

Deti vetëm është det.

E polli ura ylberin, harku mbi hark,  
mu në ditëlindjen e detit.

## PUNISHTJA E ËNDRRAVE

valët e ujit  
valët e shkretëtirës  
punishtja e ëndrrave në mes

valët e pikave  
valët e pluhurit  
kristale me thërrime të arta

pa fener e pa busolë  
diçka pa emër e kërkoj  
këtu.

Dalëngadalë  
po çbëhen  
projektimet.

## JETLAG

nga toka të reja të vjetra të ngrohta po kthehem  
nga toka jote diellore deri tek imja  
me këngë të ndritshme në gojë dhe në lëkurë  
che, flamuri yt qenka qielli ynë  
jam vajza e diellit thashë në ngjyrat ku u rrita  
në natë dhe të gdhirë pa qarë

a e di, çdokush e ka detin e vet  
njerëzit e tu të bardhësisë gjiri im i shqiponjave  
prandaj qenkam me jetlag, che  
që është më i fortë kur kthehesh nga perëndimi  
deri te deti im zjarret e mia nga detet  
dhe legjendat tona  
të natës në gjuhë të harruara

po kthehem nga ti tek unë  
nga mure të larta me ushtarë nga kohët e kaluara  
dhe nga ballkoni yt me jaseminin nga sot  
ose së paku  
nga dje dhe kurrë dhe një natë mes kohësh

jetlag në damarët e mi jetlag shqiponje  
shpendi me mall për hyjneshën time  
të cilën ti nuk e kupton  
jetlag në udhëtime të pafund nga ti tek unë -  
a e di, ëmbëlsia e zemrës nuk vdes.







## VI SAKARTVELO<sup>4</sup>, MACET E TUA

---

4 Sakartvelo = Gjeorgjia në gjeorgjisht

## ZONJËS Q

**G**otat ishin thyer dhe shikimi im shponte  
mjegullat e hapësirës dhe të fatit.

**E**rdhi koha për të harruar kohën, për të  
plotësuar rrathët e ngelur të parrumbullakët.

**N**uk di si të gjeta, si më gjete, vajzë pa nënë,  
nënë pa vajzë, mbi këtë rruzull me male  
dhe pemë dhe njerëz.

**A**thua, në këndin tënd pjellor të Nënës Tokë  
më ke pritur pa ditur, një vajzë  
për t'i thurur gërsheta?

**C**ili është burimi, cilat janë rrënjët, cila është  
Toka ushqyese e zemrës sate të çuditshme?

**V**erën e mban Toka jote në bark, dhe bukën  
e ka për dhëmbët që nuk tremben nga betoni.

**A**të natë, një mace fluturoi nëpër errësi,  
e çjerrë, me një hardhucë në tru, e unë  
të thashë: Moj Nënë.

**L**ejomë që të ndaj qumështin tënd amtar  
me fëmijët e braktisur në rrugët e qytetit.

**E** humbur dhe e gjetur u struka në zemrën  
tënde të gjerë, dhe drita depërtoi nëpër gjithë  
gurët e Qytetit Gur.

## E ËNDËRROVA KAHETINË

Nuk më ka djegur dielli i Kahetisë.

Përse nuk vajta  
me gjithë ëndrrat përtej detit, në lberinë e re,  
kur anijet më ftonin për pyjet e hijshme rrushi.

Përse nuk vajta  
me buzëqeshje të pafund nën shputat e këmbëve,  
që kanë kërcyer zemrat e gjithë botës përveç  
Kahetisë.

Kaheti, moj K'akheti, një vit të tërë të ëndërrova,  
viset e lyera me ar hardhish dhe buke,  
ëndërrime të pafjalë, të ndara, ëndrra vere

të tradhëtuarë në çast  
për një rajon tjetër. Nuk e pashë Kahetinë time,  
ëndrrën mes telave me gjemba  
dhe kaltërsisë së detit.

Kaheti - pse nuk vajta  
edhe pa Ty!!

## GJENERATORI NË VRESHTË

Askush nuk do të më ndërtojë  
një gjenerator në vreshtë.

Kompjuteri im do të mbetet i përmalluar  
për dehjen që ngrihet nga dheu i njomë vreshtash  
në një mbrëmje ëndërrimtare vjeshte, pa korrent,  
se këtë dheun e njomë nga shirat  
e gjen vetëm në provincë,  
ku fabrikat janë përrallat e pëshpëritura  
nga kokrrat e rrushit.

Memorja e tij mban fotografinë tënde. Nuk  
e shikoj më.

Por nuk e fshij, nuk di përse. As unë nuk  
dehem më.

As nuk u deha me gjakun e vreshtës, me  
gjakun tim e tëndin.

Më janë mbetur midhjet e zbrazëta  
dhe një unazë guacke,  
të sjella nga dallgët e ftohta, të kripura,  
të hidhura, të mia.

Se ti nuk do të më ndërtosh  
një gjenerator në vreshtë.

## ATIJ QË VJEN NGA VRESHTAT KU LIND DIELLI

Nënë e kam pranë. Një nënë  
për t'i mbledhur lule.  
Nëna jote. Por ti,  
me dy ullinj në mes të ballë  
në një botë topash dhe temjani,  
ke bërë nga gjoksi im  
një varr të zbrazët  
nga humbja, jo nga ringjallja.

## NË RRUGËN E ESHTRAVE

ndoshta në rrugën e eshtrave  
do të gjej ndonjë përgjigje

edhe pse kockat i kam të përziera  
asnjëra nuk gjendet në vendin e vet  
pa u riparuar nga mjekë japonezë a hindusë  
pa u vajtuar nga plaka  
të Labërisë a Svanetisë  
po nisem në rrugën e eshtrave

nën ato harqe me shkëlqim nënatyror  
që më kujtojnë atë makth në shtëpinë  
e të tri maceve  
ku kalova një dhomë pas tjetrës, pa u trembur  
nga përbindëshat  
që më shtëndosnin gishta baltakë dhe më  
ngulosnin sy shtangës  
nuk u tremba se thirra papushim  
atë emër pa përgjigje

ndërsa tani gjendem para një rrëmuje eshtrash  
pa rregull dhe pa udhëzime për montim  
vetëm kujtime nga ndonjë mësim shkollor:  
ja brinjët  
kafazi për enigmat e mushkërive dhe të zemrës  
pa frymëmarrje dhe pa ngrohtësinë e gjakut

atëherë hyj në atë kafaz të kotë

që prapë më kujton makthin në shtëpinë  
e të pesë qenve  
ku me të dalë nga gjerdani i dhomave  
me përbindëshat  
përjashta, më në fund, një parmak të madh,  
të bardhë  
ia dhurova zërin emrit tënd, që asnjëherë  
nuk jep përgjigje

më mbyti jehona e boshllëkut në zërin tim  
më mbyt jehona e zërit tim prej ashti

## HOTELI I REFUGJATËVE

na urrenin sigurisht  
ata refugjatë kosovarë që  
prej vjetësh mbushnin hotel "Butrintin"  
duke e kthyer  
çdo natë në një mozaik dritash  
(kur kishte korrent)  
çdo herë që hapja sytë ishin atje këto drita  
që natën kur përveç dashurisë nuk mendon gjë  
të kujtojnë se çdo besim është iluzion  
përveç realitetit të luftës dhe ikjes  
dhe të këtij mozaiku që ndërrohet  
më shpejt se hëna

sigurisht neveriteshin ata  
(mos shiko jashtë, kjo është më keq se lufta)  
me qindra dashnorë gjatë netëve të viteve  
që besonin që thjesht me t'i mbyllur sytë  
do të zhdukej hotel "butrinti" dhe me të  
do të shlyheshin të tëra dhembjet e dheut  
edhe unë mbylla sytë  
duke e njohur botën e prandaj  
lakmoja verbërinë e kuajve me pafta  
ose të rrugëve ku kundërmimi zë vendin e dritës  
por ishte vera e dashnorëve në plazh kështu që  
fatkeqësisht nuk iknin dritat ose së paku jo  
në këtë qytet shprese e zhgënjimi  
dhe kosovarët sidomos adoleshentët  
me tru të trazuar



grumbulloheshin nëpër dritaret  
që mbyllen nga deti  
nuk kishin lekë për kinema as nuk u nevojitej  
se ky spektakël tejkalonte ekranin e prandaj  
kur takoje në rrugë refugjatë të rinj dyshoje  
a mos u binin sytë nga balli në shesh

atë natë na shndritte patjetër mozaiku i "Butrintit"  
(a quhej vërtet "butrint" ky hotel refugjatësh?)  
u kthye në imazh të pashlyeshëm kujtese

nostalgjike

dhe kur pas përmbysjes dhe rilindjes së botës  
hapa sytë

hotel "Butrinti" befas ndodhej në anën tjetër  
kishte ndërruar vendin si hëna vetë dhe u çudita  
pa masë dhe doja të të shikoja në sy  
por sytë e tu nuk i gjeta asnjëherë e prandaj  
u nisa ta kërkoja detin

## PESË LUMENJ GJEORGJIANË

### CHOROKHI

krahë të panumërt të argjendtë te derdhja  
ku krokodilët fërkojnë nofulla jeshile  
dhe shirat tropikale fshehin miza në orkide

këtu janë fundosur të gjitha furgonet ku dëgjova  
këngën e dashurisë në ditët e para

### RIONI

notojnë djem të shkujdesur në ujin e kthjellët  
lopët vështrojnë me sy të zgurdulluar  
makinat, motoçikletat dhe përshëndetjet në traget

sa afër është shtëpia e poetit të vdekur  
i fundit që e vrau veten për dashuri

### LIAKHVI

në bregun tjetër presin tetë kazakë dhe prehin  
me kokë të prerë dhe frikën në një gotë raki  
medalje olimpike në TV-në e prishur  
dhe qirinj në kishat

shko pa më thënë lamtumirë kur të thërret lumi  
se dhe në këtë breg më ke qenë i vdekur

## MTKVARI

këtu vriteshin studentë në luftë civile dhe atje  
presin refugjatë për kalimin e kotësisë  
një mace e ngordhur nuk pret asnjë furgon më

thonë se lumenjtë të ngushëllojnë, sa gabim  
dashuri në majë të gishtërinjve – pafundësisht  
e largët

## ALAZANI

gjerësia hapësinore shtrihet në zanorët e gjata  
si pulëbardhat e kujtimit nga qyteti im i artë  
këtu mbaron bota që s'e njeh dhe fillon e njohura

po të pish nga ky ujë harron se të harroi i dashuri  
sa më thyhet zemra për këtë lumë  
përherë të andejmë

## NJË DITË PARA SHPËRTHIMIT TË LUFTËS

Në ditën para shpërthimit të luftës,  
dielli ndriçonte nga një qiell i kaltër,  
mushkonjat vallëzonin e pickonin;  
ne dëgjonim lajmet dhe dinim çdo gjë  
dhe asgjë dhe prisnim  
dhe ishim gati. Për të luftuar, për të vrarë,  
për të vdekur. Ashtu si mund të jesh gati  
vetëm në një ditë verore.

Në ditën para shpërthimit të luftës,  
u zbritte nga një furgon gunga-gunga.  
Dielli rrezatonte  
në bluxhins, me çantë të madhe shpine.  
Pa syza këtë herë, pa biçikletë.  
Për një çast harruam gjithçka, por ti qave  
për luftën  
dhe për vëllezërit e tu edhe për mua.

Në ditën para shpërthimit të luftës,  
ti the: "Unë nuk të dua më"  
me sytë e një tigri. Në fillim nuk ndjeva gjë  
veç diellit, e pastaj  
lufta ishte më e lehtë. Çfarëdo të ndodhte,  
do të më takonte vetëm mua.  
E mbaja vetëm luftën time. Jo tënden.

Në ditën para shpërthimit të luftës,  
shoku ngriti gotën në dritë: "Për frikën tonë.

Unë kam grua dhe fëmijë, ti s'ke njeri  
përveç vetvetes,  
por secili e ka frikën e vet. Të pimë për të".  
Ne prisnim dhe i njihnim armët tona,  
por jo luftën,

por frikën time nuk e gjeta dot;  
në gotën time notonte  
vetëm një shkëndijë miqësie.  
Piva, dhe shkëndija më përshkonte me not  
e vallëzonte  
si retë e imta të verës, si tigrat e mushkonjat,  
dashuri e vdekje,  
ndoshta në ditën e fundit fare, para  
shpërthimit të luftës.





VII PAS TËRMETIT

## SHPËTIMI I LULEVE

Në çastin e fundit,  
lulet u pajisën me pedale  
- nga një dorë e mëshirshme  
ose në mutacion të urtë -,  
u hipën biçikletave të tyre  
dhe ikën nëpër gjashtë qafat e botës  
për t'u strehuar në këngët e Labërisë  
dhe në grykat e topave të Ali Pashës.

Njerëzit që i panë – nuk ishin shumë –, u çuditën.  
Një grup çobanësh me qentë dhe blegërimet  
si dhe tre emigrantë nga Greqia  
me bagazhin plot dhurata.  
Tej mase u çuditën, sepse kurrë s'kishin parë  
lule mbi biçikleta.  
E shikuan njëri-tjetrin, të tronditur  
dhe të mrekulluar,  
dhe nuk ia thanë gjë askujt,  
se nuk do t'ua kishin besuar.

Kështu shpëtuan të gjitha lulet e Sarandës,  
se lulet janë gjithmonë të para që ndiejnë  
ato shenjë, dhe veprojnë  
duke u bërë vetë shenjë të papërfillura  
për njerëzit e mbytur në gjumë.  
Ditën tjetër ndodhi tërmeti.



## EKZIL DETAR

Jo. Tsunami nuk ishte as nuk do të ketë kurrë.  
Mua deti nuk më tradhëton. Së paku kjo  
më ka mbetur. Së paku deti,  
mbreti, i cili ia shtrin dallgën edhe këtë herë  
shpirtit tim të kërrusur. Për ekzil  
nga një vend që mbaroi. Por duke pasur  
mosvendin tim mbrapa shpinës,  
vend-mbarimin, botë-mbarimin, jetë-mbarimin,  
gjithçkanë time të kthyer në hiç,  
para syve të mi, deti është.  
Në këto çaste, diçka merr frymë, e diçka fillon.  
Dhe në këtë vijë të hollë, së cilës  
dikur i thoshin bregdet,  
dhe që tani është vija që ndan shkatërrimin  
nga ribërja,  
dëshpërimin nga shpresa, jo-në nga po-ja,  
unë, e ulur në bashkimin e elementeve: deti,  
dielli, dheu, era edhe një pulëbardhë,  
ndiej si hiçi më ngulet nga mbrapa si thika  
e vrasësit në shpinë,  
ndërsa nga gjoksi dhe duart  
dhe sytë mbin diçka –  
unë, kazani i zierjes së supës zanafillore,  
vapë, dhembje, tmerr, ena alkimiste,  
unë, krizalidë detare, jo për vetën, por  
për një botë.

## HUTA

Këtë sqep të hutuar e njoh.

E njoh nga ajo kohë e largët kur unë,  
foshnje me trup vigan,  
thitha nga sqepat hyjnore ninulla dhe premtime,  
kështu që, si Abrahami pa kope  
dhe Jasoni pa anije,  
ndoqa gjurmën e pendëve të zeza  
të përlyera me gjak.  
Dhashë zemrën. Dhashë të kaluarën  
dhe të ardhmen time,  
pezull në çast të padukshëm,  
të gërryer nga të dyja anët,  
me vezullimin e syve të mi, që ndriçonin si yllësi  
me kontakt të luhatur.

Pashë Zotin, e njoh këtë sqep të hutuar  
si në legjendat e kahmotshme  
dhe në filmat e kohës,  
grabitqar, lakmitar, llupës në indët e mia,  
o Zot, përse ky sqep kaq familjar,  
pse pikërisht kjo palë sqepash në një trup  
të braktisur në një bregdet të braktisur

medet, këtë palë sqepash, sa e njoh  
këtë hutë  
e njoh

## PEJSAZH BREGDETAR

Ëndrrat i kanë braktisur varkat  
Dhe varkat i kanë braktisur  
Ëndrrat dhe shkollat e peshqve.

Kush do të jetë në timonin e  
Barkës Diellore?

Rrjete të thyera kapin boshllëkun memec  
Ku asnjë sy nuk lexon shkëlqimin  
e hapësirës së dëlirë.  
Një fener invalid, kokëthyer, rënkon pa zë.

Kthehu te faraonët. E ke kryer punën tënde këtu  
Të cilën dhe gurët e tu e injoronin  
Mbylli sytë e kthehu.

Një pushim i amshuar peshon  
Si retë në krye të ditës në një stinë  
të papërshtatshme.

Rrënojat janë të rraskapitura së qeni  
Objekt investimi dhe spekulimi,  
objekt xhelozie dhe shprese.  
Ofshama të lehtësuara: nga objekti në pluhur.

Dallgët kanë rrëmbyer  
dhe do ta shpëlajnë gjëkundi  
Një timon binjak jetim.

## MUSHKËRI

Një mushkëri vrapon vrapon nëpër pyllin e virgjër  
nëpër pyllin e verbër me gjemba  
me gjemba që ia shpojnë mushkërisë  
flluskat e vockla  
sikur të ishin flluska sapuni në ngjyrat e ylberit  
sikur të ishte bukuria diçka e vërtetë  
e qoftë vetëm  
deri në shpërthimin e flluskës-flutur  
por mushkëritë që shpohen  
kolliten si poetët për të cilët lexuam  
në shkollë të cilët e pështynë veten dhe kështu  
morën fund dhe këngët ngelën të pakënduara  
dhe frymëzimi mbeti pa frymë  
si sot televizori mbetet pa rrymë  
pa gomarët e grindjeve politike të zgjedhjeve  
që futen me bajonetë në pallatet e përrallave  
duke i shpërthyer me dinamon e Tiranës  
çka të bësh  
ha çamçakëz se ky nuk mbaron kurrë  
përtype sot përtype nëpër shekujt  
pa pyetur përse  
dhe me cigare të holla siç janë në modë  
dërgoji mushkëritë me vrap nëpër pyllin.

## ANKTHET ZANAFILLORE

Buzët e përvojës kërcasin ende.  
I njoh të gjitha ankthet e njerëzimit,  
ato të shpellave dhe ato të stepave.  
Të vdesësh nga brenda  
duke filluar me stomakun e zbrazët.  
Të vdesësh nga jashtë  
duke filluar me lëkurën e ngrirë.  
O sahelianë, siberianë, shqiptarë –  
asgjë në këtë rruzull, sot si pardje,  
nuk më është e panjohur.

## VENDI I SHENJTË

Ti vendin e shenjtë e gjen kudo,  
dhe kur nuk e gjen, e ndërton:  
mbi çatinë e një pallati në geto,  
në syrin e tajfunit të luftërave të tua  
të keqkuptuara  
si dhe në sytë e pezmatuar të një qeni rruge.  
Nuk të ndalon as hekuri, as betoni,  
dhe si bimësi të shërbejnë vetë lulet e zemrës.  
Mos lejo që kjo zemër të mbyllet  
për një qindarkë,  
një copë letre, një shikim të shtrembër,  
botëndërtuesja jonë, rri, qëndro, ndriço për ne!

## FELICITAS

Kjo është shoqja ime, që nga fëmijëria,  
kur vallëzonim, dëgjonim disqe,  
nënqeshnim për çunat,  
kur më ngushëllonte dhe shpëtonte  
nga kënetat e urrëjtjes dhe veturrëjtjes.  
Zëri im i artë dhe i urtë më është bërë  
shoqëruesja ime e lehtë si fllad,  
ngrohëse si palltoja e diellit në verë.  
Vetëm unë e shoh, unë e ndiej, unë e njoh.  
“Mos fol për të, se do të tallen të tjerët”,  
tha gjyshi,  
dhe nëna: “Mos je skizofrene?”  
në ditëlindjen e saj,  
kur kisha mbledhur ëmbëlsira,  
se patjetër duhej festuar.  
Ja, kjo është shoqja ime, që ishte dhe s’ishte,  
që vazhdon përherë,  
e pandashme nga unë me urtësinë e saj,  
si engjëlli im mbrojtës.

## KOKTEJ SHËRIMI

Në koktejin për shërimin do të fus:  
Pesë qenë të rrugës – kurrë më  
s'do të jesh e vetmuar.  
Polifoni dhe klarineta – që harmonia  
të ngelet në vesh, e pastaj në mend.  
Hënën dhe diellin të mbështjellur në vargje  
– që bukuria të mos të braktisë kurrë.  
Dhe për uri, për etje dhe për dhembje:  
Byreqet e Nikos. Kakaon e Spiros.  
Hapet e Vangjelit.



## VRIMA E ZEZË

Kjo vrimë e zezë nuk asgjëson vetëm  
dritën, por edhe  
fjalët.

Megjithatë ka këngë që ngecen në fyt  
dhe që më godasin nga brenda  
me grushta të vegjël,  
të pistë, me thonj të ndyrë,  
grushta të vegjël të mbyllur fort deri në gjak.

## MIKPRITJE

Ty nuk të ftoj më. Ti kurrë nuk vjen.  
As me vonesë nuk vjen.  
Dhe po të vije – sikur të vije ndonjëherë!  
– nuk kam ç'të jap.  
Nuk di kë të ftoj. Nuk di ç'të ftoj.

Atëherë më le të ftoj atë që është.  
Batanijen e strehimores, edhe pse e hollë,  
Qiellin e kaltër mbi malet, edhe pse i ftohtë,  
Frymëmarrjen time, edhe pse e rënduar,  
Ndonëse jam kudo, kurdoherë e mërguar,  
Ndonëse jam.

## KY GUR GJOKSI

Ky gur gjoksi përmban dhembjen  
E botës – një bote me mijëra lindje  
Dhe mijëra vdekje në një gjoks të vetëm.

Vesh, o vesh, dëgjojiani muzikën!  
Do të bien mure  
Do të thahen oqeanë  
Do të kthehet e jashtëmja brenda  
dhe e brendshmeja jashtë.  
Vesh, o vesh, mos u trembni!

Se ankthin e qoshkave të fundit të botës e thithi  
Ky gur i dashur gjoksi  
Me faqe të kruspulluara pa formë  
Por që përmban të gjitha trajtat e Jetës.  
Ky gur gjoksi i shëmtuar  
Të cilit mjekët vetëm me ngurrim i vunë një emër,  
Ka thithur edhe përpëlitjet e shpirtit tënd,  
si sfungjer,  
Për ty, dhe i mbush me lëngun e jetës, me muzikë,  
Me muzikë.

## PIRATJA

Këndoj në furtunë. Këndoj.  
Për delfinët që kurrë nuk vallëzuan me mua.  
Për rrjetet që nuk i nxora me peshq  
nga thellësia.  
Për bankën në barkën e peshkatarëve,  
mbi të cilën nuk u ula.

Bërtas në furtunë. Aaaaah!  
Për plazhin e parë të humbur  
në malet e plehrave tuaja.  
Për plazhin e dytë të humbur në kundërmimin  
e jashtëqitjeve tuaja.  
Për ëndrrat e humbura, shpresat  
e humbura, veten e humbur.

Jam në furtunë. Jam furtuna.  
Ja, në direk, flamuri im valëvitës:  
zemra ime e vyer, e thyer, e shqyer.

## NDËRRIM

Kur botë të jashtme nuk ka  
Ose ajo është e pagjetshme  
Ose copat nuk mjaftojnë për të formuar botë  
Atëherë  
Kthehen sytë nga balli në mes të kafkës  
Dhe lëkura bëhet një thes përreth universit  
Dhe përsëri Fjala do të fillojë veprën e saj  
të Krijimit.

## DERDHJA E DRITËS

Vetëm një herë u derdh drita  
Por atëherë u dogj  
Gjurma e zjarrtë në retinat  
Dhe njerëzit i ngritën sytë lart  
Ku para pak kishte qenë ende kjo dritë  
Nga zhduken të gjitha dyshime në tru  
Dhe të gjitha njollat e zemrës dhe hijet e shpirtit.  
Prandaj i ngritën sytë në pritje,  
Që nga e zbehta u shua në të zezën.  
Por në të gjitha retinat  
gjendej kjo gjurmë e vockël  
Si provë e pashlyeshme e ngjarjes,  
Kështu që njerëzit zgjatën qafat e trasha,  
Që u bënë si mjellmat në ylber,  
Dhe shpinat e kërrusura u drejtuan  
Dhe duart lëshuan pe nga dheu.

## FSHAT SHQIPTAR

Fshati ynë ndodhet nëntëqind kilometra mbi detin  
Si kështjellë e pamposhtme në mes të reve,  
Ku edhe shqiponjave u është tepër i hollë ajri.  
Por ne e ndërtoam në kohën ilire,  
se diellin e donim,  
Për t'i banuar më afër. Edhe  
Për shkak të shpendëve, ishim në garë,  
në kohën e motshme,  
Kështu na këndojnë rapsodët në sofër midis resh,  
Garë se kush ngre folenë më të lartë. Fituam ne.  
Pastaj na hynte shumë mirë në punë  
kjo pozitë strategjike.  
Shtëpitë tona nuk u dogjën. Gratë tona  
nuk u përdhuan.  
Foshnjët tona nuk u nxorën me shpatë nga mitra.  
Po shqipen tonë, sa e ruajtëm,  
sa më të kulluar nuk ka poshtë në dhe!  
Por aman, aman! Nëntëqind kilometra  
larg detit!  
Përrallat tona nuk flasin për kuçedra,  
për zana apo xhuxhmaxhuxhë,  
Por për rrjetet e plota të peshkatarëve.  
Për perlat në mes të guackave  
Dhe për delfinin që shpëtoi një detar.  
Aman, aman! Nëntëqind kilometra larg detit!







VIII LUMI QË RRJEDH DREJT BURIMIT



## RRUGA

Nëpër perden e shirave të qerpikta  
shoh rrugën. Por edhe këmbën time  
me rruzullin e të burgosurve.  
E mbajtur peng në rruzull.  
Por edhe rrugën. Atje ka pemë, diell, njerëz.  
Po që se ngelem në vend,  
duhet t'i mbyll sytë,  
përndryshe drita e rrugës ma shpon zemrën.  
Po që se hidhem në rrugë,  
klithma e kyçit të këmbës  
nuk do të më braktisë më.

## YLLI

Sot në mëngjes gjeta një yll mbi pjatën e bukës.  
Ishte i ngrohtë ende, si simitja,  
dhe ndriçonte më shumë se xixëllonjat.  
Nuk guxoja ta prekja me gisht.  
Ç'dreqi kërkonte në pjatën time?

Yjet zakonisht shfaqen në ëndrrat,  
që mua më tmerrojnë,  
ose në sytë e një të dashuri,  
që thonë se ekziston.

Ishte më i madh se pikat që sheh në firmament,  
por aq i vogël sa e ndante pjatën me simiten.  
Nuk kisha si t'ia ktheja qiellit,  
asnjë raketë për ta thyer gravitetin.  
Ndoshta nuk ishte për t'u kthyer kurrë.

Të mos rrinte larg,  
i vockël si një pikë gjilpëre,  
i papërfillur nga të gjithë,  
ku largësia do t'ia kishte ngrënë dritën.

Të ndriçonte me sa fuqi kishte, mu këtu,  
mes nesh. Mbi pjatën time të mëngjesit.  
E kapa dhe për çudi ai nuk ma dogji gishtin.  
Simitja më ndihmoi për ta gëlltitur.  
Po ylli më është ngecur diku pranë zemrës,

ku tani ndriçon tutje ...

## UJKU I ERËS

Lumenjtë, detet, malësitë, ti i përbuz,  
i mbifluturon si rrufe

**A**s nuk të mbajnë pang mendimet e ngurta  
se gjoja je qen.

**K**ozmosin e përshkon dhe e bashkon me erën,  
binjakun tënd.

**O**, fluturo dhe për mua, shpirtin tim ngreje lart,  
**Ylber** i bardhë midis tokës dhe ëndrrës!

**Ti** beson se je ujk. Qenke ujk. Qenke unë.

**A**sgjë nuk do të ndalë më hapjen e krahëve të mi.

## GËRSHETA TINGUJSH

Gërsheta, gërsheta tingujsh drejt qiellit,  
të lehta dridhen filizat në koreografi të paparë  
nën hënën mes yjeve.

Aty poshtë do të vriteshin,  
të shkeleshin, të shqyheshin.  
Aty, ku mijëra gërsheta të tjera  
presin lëshimin, që mund të mos vijë.

Hëna nuk rrezaton rrezik.  
Yjet nuk rrezatojnë vetmi dhe izolim.  
Dhe nata është aq e kaltër saqë gërshetat  
thurin mes vete një sinfoni.

## FUNDOSJE

lumi i furishëm  
që më rrëmbeu  
bëhet më në fund  
oqean i thellë

i pakapërcyeshëm  
ndarës.

Por thuajia këtë qelizave në vorbull!  
Përpigu t'ua ndërpresësh vrullin!  
Syrin që papritmas u hap,  
"mbyllu" i thua?  
Guacka e thyer nuk mbyllet dot më.

tani  
në fund të oqeanit  
një zemër përpëlitëse  
i bie daulles  
Tokës.

## PEMËT

Më frymëzojnë pemët!  
Më ngushëllojnë! Më ringjallin!  
Ç'do të ishin të gjallët pa oksigjenin e tyre!  
Ç'do të ishin të vdekurit pa hijen e tyre!

Kur isha e re, dashuroja një pemë.  
Ajo mua nuk më dashuronte.  
Por kishim biseda të thella,  
dhe shpirtrat tona mbështeteshin në hije.

Ah, këto pemë!  
Herë na ngatërrojnë, herë na rindërtojnë!  
Flokët tanë, ç'do të ishin pa zogjtë e tyre!  
Këmbët tanë, ç'do të ishin pa krimbat e tyre!

Dashuroja një pemë,  
më shumë se të gjithë dashnorët e shtratit.  
Nganjëherë e merrja në telefon,  
dhe dilnim në kala ose në kinema.

Ah, pemët! Ah, pemët!  
Ku na kanë fluturuar me gjethet e tyre?  
Kush na flet tani për Zotin?  
Kë ta dashuroj tani?



## KUMBUJ

kur dola nga shtëpia  
më vra në kokë  
një kumbull

Më la i dashuri!

rrëzohen kumbujt nga pemët e tyre  
nuk duan t'i mbajnë më  
degët e përkulura

Më la i dashuri!

ngjyrë vjollce u vrenjt qielli  
kumbuj në shtrëngatë apokaliptike  
kumbuj kumbuj kudoherë

Më la i dashuri! Më la i dashuri!

më në fund gjeta kapelën e zezë  
do të më mbrojë  
penda e saj prej pallua

## DRERI

Stërgjyshërit na këndonin shkurrat  
e shkretëtirat andej,  
përtej maleve, nga erdhëm, nga lind dielli.  
Por nga dielli ne na shkëputi  
ky dre i artë, bekimi i popullit  
në kërkim të vetvetes në hapësirë.  
Ndaj fëmijët na këndojnë për stepat përpara,  
për çadrat nga guri në përçafim me qiellin.

Drerin e mrekullueshëm, unë e mallkoj  
me kokrriza rëre dhe gjemba shkurre në zë,  
se na shkuli nga dheu, nga lindëm si dielli vetë.  
Diellin e ndjekim, më thotë motra, se atë  
e ndjek dreri, që rrugën e njeh,  
deri atje ku dielli nuk vdes kurrë.  
Se të lëvizshëm jemi si kuajt vetë,  
më thotë Fëmija i Kryqit,  
por do të vijë dita kur të ngremë çadra  
nga guri dhe druri.

Por mallin për stepat e lëna prapa malësisë  
e ruaj në çdo fjalë të kënduar, përherë.

## ËNDËRRUESI

Vetëm në ëndërr mund të gjesh  
rrugën për të çuar një popull  
në një vend të ri.

Pasi shpendi magjik, im atë,  
u ul i hekur në urën e madhe  
dhe dreri i mrekullueshëm u thye në gjak,  
më erdhi radha mua.

Se ka një rrugë të padukshme midis maleve,  
që nga shpellat e gjumit ndriçon si hekur i lëngët,  
e shtruar nga bota e andejme, vetëm për ne.  
Unë kam detyrën e shenjtë  
ta gjej me sy të mbyllur.

Pra natën më thith qetësia, që ruan mistere  
dhe përgjigje,  
por në mëngjes palosen tendat, kuajve  
u vihen parzmore, zgjohet një popull i tërë,  
se të gjithë, të gjithë më besojnë  
se diku gjendet një vend i bërë për ta.  
Ndërsa unë, vetes nuk i besoj.  
Vetëm asaj gjurme të nxehtë, që shkrepet  
natën në mendjen time të fjetur.

Se vetëm në ëndërr mund të gjesh  
rrugën për të çuar një popull  
drejt një shprese të re.

## KURORA MBRETËRORE

Jo! Jo kurorën! Jo mua!  
Mos guxoni të më kurorëzoni!  
Si mendoni që unë, pikërisht unë,  
jam i aftë dhe i denjë për ta sunduar vendin?

Shikoni: unë nuk jam i korruptuar.  
Nuk dua të luftoj. Nuk dua të gënjej.  
As grushtin e hekur nuk e kam.  
Nuk urrej asnjë parti, asnjë njeri.

Ikni! Mos më prekni!  
Mos ju kujtohet që ju vetë më thatë:  
vendit i duhet një dorë e fortë?  
Ikni me gjithë kurorën tuaj!

ja  
rrethi nga metal i nxehtë  
po shkrihet me kafkën time  
ja mbi kurorën, kryqi i tërthortë  
si antenë për Dritën  
që po derdhet në trurin tim

në emër të Dashurisë  
e pranoj nderin e mbretërimit  
me mjetet e Dashurisë  
do të veproj për të mirën  
që Dashuria të zbresë nga qielli  
për të zënë vend të pashlyeshëm  
në zemrën e çdo njeriu

## KOHA E KORRJEVE

Ka ardhur koha e korrjeve  
Në vjeshtën e artë  
Të gjetheve që bien për t'u kthyer nga janë nisur,  
Në përqaqim verbues të rrezeve të arta  
dielli me tokën  
E kaftë, të rrumbullaktë dhe ende  
një çikë të ngrohtë,  
Dhe çohen njerëzit që në brendi zbulojnë  
jehonën e ngjirur  
Të klithmave shtegtare patash në udha-shigjetë.

Ja, në kohën e korrjeve, në vjeshtën e artë,  
Zogu i zemrës sime, që nga shqiponja  
e stërlodhur nga trimëritë  
Ishte bërë pulëbardhë në shkëlqim xixëllues,  
Tashmë lëshon, pa u penduar më, gjithë  
bardhësinë e saj  
Për t'u nisur në drejtimeve të kundërta  
në të gjitha horizontet  
Duke ngritur fuqinë e shqiponjës dhe paqen  
e pulëbardhës  
Në lartësi të padëgjuaara më parë.

Ka ardhur koha e korrjeve,  
Koha e dridhjes së pupllave të bardha  
dhe gjetheve të arta  
Në vorbull, në valle, drejt tokës, drejt qiellit,  
Përzierje, shndërrimi, vdekje, rilindje –

Ja koha që nuk lë asnjë gur mbi tjetrin  
Kur shemben botat dhe unë lind një yll të qeshur  
Për t'u treguar patave të natës një udhë  
si frymëmarrje të re  
Në kohën e korrijeve  
Në këtë vjeshtë të artë.

## PËRMBAJTJA

I	LETRA NGA FERRI . . . . .	9
	FRYMË . . . . .	11
	RIMË . . . . .	12
	IKJA . . . . .	13
	BARKU I MADH I HISTORISË . . . . .	14
	BARKA E VOGËL E HISTORISË . . . . .	15
II	NËPËR DETIN E SYRIT . . . . .	17
	IRIQI TEPËR I DASHUR . . . . .	19
	TRUPROJA . . . . .	20
	POEMTHI I LODHUR . . . . .	21
	KEQMËNGJESI . . . . .	22
	ISAKU . . . . .	23
	STYX . . . . .	24
	UDHËTIM . . . . .	25
	RËNDESA . . . . .	26
	KËNGË PËR NJË FËMIJË TË URITUR . . . . .	27
	MASKARA . . . . .	28
	HIK FËTI . . . . .	29
	FUNDI I NJË PULE . . . . .	30
	PËRHERË PËR TË KËNDUAR . . . . .	31
	KISHA NJË HERË NJË PËRKTHYESE TË BUKUR . . . . .	32
	DHËMBË DIMRI . . . . .	33
	PSHERËTIME GJERMANISHT . . . . .	34
	SHIGJETA DHE STËRKALA . . . . .	35
	SHI SI HEKUR . . . . .	36
	RRUFE . . . . .	37
	LUMI NUK RRJEDH PËRPJETË . . . . .	38
	POLIS . . . . .	39
	VATRA . . . . .	40

ISHA . . . . .	41
NDIHMËI . . . . .	42
URI . . . . .	43
AUTOBUSI. NATA. PISHA. . . . .	44
VAJZA VAJZA KOLOVAJZA . . . . .	45
<b>III TOKË NË DETIN E SYRIT. . . . .</b>	<b>47</b>
JETUAM E JETUAM . . . . .	48
E LEKTORUAR DERI KETU. . . . .	49
NYJE . . . . .	50
MUR, MUR BËHET GUR. . . . .	51
MBI KUDHRËN E JETËS . . . . .	52
GRUAJA QË HANTE PROTONE . . . . .	53
JETA NË FYTIN E NJË PËLLUMBI . . . . .	54
BRICJAPI QË DEL NGA JANARI . . . . .	55
VASHA . . . . .	56
ZËRI IM ! . . . . .	57
DËSHIRORJA . . . . .	58
DOLA NGA BODRUMI . . . . .	59
O TIRANË . . . . .	60
ALLIAS . . . . .	61
GJYSHJA SARANDJOTE. . . . .	62
TRI DHITË . . . . .	63
GJARPRI . . . . .	64
SHPELLAT . . . . .	65
DHURATA. . . . .	66
PANTA RHEI . . . . .	68
<b>IV NË VENDIN E DARDHAVE. . . . .</b>	<b>69</b>
MBYTJA E SHQIPTANIKUT . . . . .	70
PUSI. . . . .	72
PLISI. . . . .	73



GRE-MINA . . . . .	74
I NUMËROJ DITËT . . . . .	75
NË VENDIN E DRERËVE . . . . .	76
RRAFSHI I TETË . . . . .	77
KOSOVA DHE UNË . . . . .	79
<b>V NUK ZËVENDËSOHET DETI . . . . .</b>	<b>81</b>
GURI NË GJOKS . . . . .	82
EDHE KARTOLLAT KANË ZEMËR . . . . .	83
MBRETËRESHA . . . . .	84
AS GJAKU NUK E ZËVENDËSON DETIN . . . . .	85
PUNISHTJA E ËNDRRAVE . . . . .	86
JETLAG . . . . .	87
<b>VI SAKARTVELO, MACET E TUA . . . . .</b>	<b>89</b>
ZONJËS Q . . . . .	90
E ËNDËRROVA KAHETINË . . . . .	91
GJENERATORI NË VRESHTË . . . . .	92
ATIJ QË VJEN NGA VRESHTAT KU LIND DIELLI . . . . .	93
NË RRUGËN E ESHTRAVE . . . . .	94
HOTELI I REFUGJATËVE . . . . .	96
PESË LUMENJ GJEORGJIANË . . . . .	98
NJË DITË PARA SHPËRTHIMIT TË LUFTËS . . . . .	100
<b>VII PAS TËRMETIT . . . . .</b>	<b>103</b>
SHPËTIMI I LULEVE . . . . .	104
EKZIL DETAR . . . . .	105
HUTA . . . . .	106
PEJSAZH BREGDETAR . . . . .	107
MUSHKËRI . . . . .	108
ANKTHET ZANAFILLORE . . . . .	109
VENDI I SHENJTË . . . . .	110
FELICITAS . . . . .	111

KOKTEJ SHËRIMI . . . . .	112
VRIMA E ZEZË . . . . .	113
MIKPRITJE . . . . .	114
KY GUR GJOKSI . . . . .	115
PIRATJA . . . . .	116
NDËRRIM . . . . .	117
DERDHJA E DRITËS . . . . .	118
FSHAT SHQIPTAR . . . . .	119
VIII LUMI QË RRJEDH DREJT BURIMIT . . . . .	121
RRUGA . . . . .	123
YLLI . . . . .	124
UJKU I ERËS . . . . .	125
GËRSHETA TINGUJSH . . . . .	126
FUNDOSJE . . . . .	127
PEMËT . . . . .	128
KUMBUJ . . . . .	129
DRERI . . . . .	130
ËNDËRRUESI . . . . .	131
KURORA MBRETËRORE . . . . .	132
KOHA E KORRJEVE . . . . .	133



Silke Liria BLUMBACH  
LUMI QË RRJEDH DREJT BURIMIT

Boton:  
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar  
"Ditët e Naimit" – Tetovë

Drejtor: Shaip Emërllahu

U shtyp më vitin 2007,  
në shtypshkronjën "Tringa Desing" - Tetovë

CIP - Katalogizimi në publikim  
Biblioteka popullore dhe universitare "Sv. Kliment Ohridski", Shkup

821.18-1

BLUMBACH, Liria Silke  
Lumi që rrjedh drejt burimit: poezi / Liria Silke BLUMBACH;  
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar "DITËT E NAIMIT", - Tetovë,  
2007; 140 f. ; 20cm. - (Biblioteka PUHIZA)

ISBN: 978-9989-2207-5-3  
COBISS.MK - ID: 69526794